

29 Dhjetor 2014, Prizren

**THIRRJE PËR OFERTIM**  
**Kompani për dizajnim dhe shtyp të produkteve**

OJQ EC Ma Ndryshe me seli në Prizren ka nisur zbatimin e projektit “Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren”. Në kuadër të këtij projekti, do të hartohen: një katalog i trashëgimisë kulturor të rajonit Jug; dhe pesë guida/pako turistike të rajonit të Prizrenit. Të gjitha këto produkte do të hartohen në shtatë gjuhë të ndryshme (shqip, serbisht, turqish, anglisht, frengisht, gjermanisht dhe italisht). Për dizajnimin/rradhitjen, zhvillimin e hartave dhe shtypin e të gjitha këtyre produkteve, EC Ma Ndryshe do të përzgjedh një kompani profesionale të dizajnit dhe shtypit, për çka ju ftojme që të dërgoni ofertën tuaj bashkë me dokumentet përcjellëse.

*Detyrat dhe përgjegjësitë*

Kompania e përzgjedhur do të ofrojë shërbime të dizajnit dhe rradhitjes, zhvillimit të hartave dhe shtypit për të produktet turistike të projektit (katalogu i rajonit Jug dhe pesë guidat/pakot turistike) në të shtatë gjuhët e publikimit (shqip, serbisht, turqisht, anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe italisht). Kompania duhet të ofrojë dizajn dhe rradhitje profesionale të standardeve të larta të cilësisë, pasi që produktet targetojnë audiencat ndërkombëtare.

*Kriteret e përzgjedhjes*

Gjatë shqyrtimit të ofertave, EC Ma Ndryshe do të ketë për bazë këto kriteret të përzgjedhjes:

- Çmimi i volitshëm,
- Përvoja e kompanisë në dizajn/rradhitje dhe shtyp (dëshmitë dokumentare),
- Staf i permanent dhe bashkëpunëtorët e jashtëm (dizajnerët),
- Referencat nga klientët (opsionale).

*Aplikimi*

Për të ofertuar për shërbime të dizajnit/rradhitjes, zhvillimit të hartave dhe shtypit, ju lutem dërgoni ofertën tuaj financiare në email adresën [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) dhe shkruani në *subject* “Ofertë për shërbime të dizajnit/shtypit”, më së largu deri më 5 Janar 2015, në orën 15.00. Aplikacionet që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen. Oferta duhet të përmbajë çmimin e dizajnit/rradhitjes për faqe, çmimin e zhvillimit të hartave, dhe çmimin e shtypit për copë (kolor) për katalog (rreth 100 faqe) dhe guida (rreth 15 faqe). Bashkë me ofertën tuaj financiare, ju lutem bashkëngjitni edhe këto dokumente: certifikata e regjistrimit të biznesit, certifikata e numrit fiskal, certifikata e TVSh-së, dëshmi të shërbimeve të mëhershme (dizajn dhe shtyp) dhe CV-të e së paku dy profesionistëve që janë të angazhuar në kompani.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë nëse e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Për më shumë informacione rreth thirrje për aplikim, ju lutemi vizitoni [www.ecmandryshe.org/konkurse](http://www.ecmandryshe.org/konkurse).

*Projekti "Mbështetje për sektorin e turizmit në Rajonin Ekonomik Jug", përkrahët financiarisht nga Ministria për Punëve të Jashtme të Finlandës në suaza të projektit "Ndihmë Tregtisë", implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*